



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. 172, Prot.

Tiranë, më 12.04.2024

Lënda: Kthim përgjigje

Z. DORIAN MATLIJA
QENDRA "RES PUBLICA"
E-mail: qendra.respublica@gmail.com

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër vendor 18 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve si dhe me aktin nr. 2179 prot., datë 16.04.2024, referuar ligjit nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 15, datë 03.06.1997 ka vendosur ndër të tjera: *"...Detyrimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë të rishqyrtojë çështjet e kërkuessave Xhemile Balavia, Igli Toska, Kujtim Bara, Artur Gumbardhi, Eduard Veçani, Kosta Kaçorri, Gjystina Dardeli, Gjon Lepuri dhe Bardhyl Lohja, duke i dhënë atyre mundësi të ushtrojnë të drejtën e mbrojtjes".*

Nga kërkimi në fondin arkivor të Këshillit të Lartë Gjyqësor rezulton se, z. Kujtim Bara ka paraqitur një kërkesë për konkurim, referuar vendit vakant të shpallur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (Gjyqtar Ushtarak), protokolluar me aktin nr. 17/8 prot., datë 15.09.2003 në ish- Këshillin e Lartë të Drejtësisë, për të cilën nuk rezulton të ketë një vendimmarrje konkrete.

Bashkëlidhur, ju vendosim në dispozicion një kopje të kërkesës nr. 17/8 prot., datë 15.09.2003 dhe vendimit nr. 15, datë 03.06.1997 të Gjykata Kushtetuese.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

RUDIN BAQLI

18/10
15 09

K E R K E S E

KESHILLIT TE LARTE TE DREJTESISË

TIRANE

Une *Kujtim Bara* me banim ne qytetin e Tiranës qe nga viti 1995, i martuar, me dy femije, aktualisht avokat prane Dhomes se Avokatise Tirane, paraqes kete kerkese per konkurim per nje vend te shpallur vakant ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tirane (Gjyqtar Ushtarak).

Kam punuar me pare ne Organin e Prokurorise Ushtarake te Rrethit Mat dhe me pas gjyqtar ushtarak dhe kryetar i Gjykates se Rrethit Mat.

Me vendimin Nr.1 date 30.03.1995, te K.L.D – se, jam shkarkuar nga kjo detyre. Kete vendim te K.L.D – se e kam ankimuar ne Gjykatën Kushtetuese te Republikës se Shqiperise, e cila me vendimin Nr.15 date 03.06.1997 ka shfuqizuar vendimin e mesiperme, duke vendosur nder te tjera “Detyrimin e Keshillit te Larte te Drejtësisë te rishqyrtoje kete ceshtje”.

Theksoj se edhe sot e kesaj dite, nga ana e K.L.D – se nuk eshte marre ne shqyrtim rasti im sipas detyrimit qe percakton Gjykata Kushtetuese ne vendimin e saj.

Si gjate punës ne Organin e Prokurorise ashtu edhe ne ate Gjyqësor, treguesit e punës time kane qene pozitive dhe gjate gjithë periudhës kam punuar per formimin tim profesional duke bere edhe disa trajnime per te cilat mendoj qe plotesojne edhe kushtet e shpallura.

Megjithate duke ju referuar njoftimit per shpallje te vendeve vakant te K.L.D – se date 01.08.2003 po paraqes te gjitha dokumentat shoqeruese qe kerkohen si: diplome, liste notash, curriculum vitae, certifikate familjare, fotografi, deshmi penaliteti si dhe deshmi kualifikimesh.

Shpresoj se kete here do te merret ne konsiderate shqyrtimi i vendimit te Gjykates Kushtetuese dhe njekohesisht edhe kerkesa ime duke u korrigjuar ne kete menyre nje padrejtesi e bere ne te kaluaren.

Me respekt
Kujtim BARA



Adresa: Rruga “Pandi Dardha” Nr.19
Laprake – Tirane

Tel: 355 522 Shtepi
Cel: 06820 42 272